



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1033_09_13**;
- Ankesa e KEDS-it e datës 20.09.2013.

në seancën e mbajtur më datë 24 tetor 2013, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e KEDS-it ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin D.D. (me shifër të konsumatorit: DPR – 18598) nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1014_09_13 i datës 04.09.2013.

Arsyetim

Departamenti i faturimit në KEK me datë me datë 04.01.2013 dhe më datë 03.02.2013 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për muajin dhjetor 2012 me 1652 kWh apo e shprehur në vlerë financiare 158.03€, respektivisht faturën mujore të energjisë elektrike për muajin janar 2013 me 1681 kWh apo e shprehur në vlerë financiare 155.53€.

Pas arritjes së këtyre faturave konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator duke kundërshtuar faturën dhjetorit 2012 dhe janar 2013 për shkak të leximit jo të saktë. Pas ankesës së konsumatorit, punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse me datë 13.02.2013 kanë inspektuar pikën matëse dhe kanë konstatuar se gjendja e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 7609063: TL=46641 kW (tarifa e lartë) dhe TU= 83195 kW (tarifa e ulët).

Departamenti për Konsumator në KEK me datë 23.02.2013 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e konsumatorit bazuar në procesverbalin nr. 2416163 të datës 23.02.2013 si dhe listave të leximit të periudhës dhjetor 2012 dhe janar 2013.

Konsumatori pas përgjigjes së KEK-ut me datë 18.03.2013 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas ankesës së konsumatorit ka shqyrtimin e ankesës dhe me datë 05.06.2013 ka nxjerr vendim duke e aprovuar ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KKDFE që: Të korrigjoj faturat energjisë elektrike të konsumatorit me shifër DPR - 18598 nga periudha 01/2013 e deri më 08/2013, ashtu që shpenzimet e energjisë elektrike të llogaritura për



këta muaj të ndahen me këtë proporcion: 50% në tarifën e lartë dhe 50 % në tarifën e ulët, dhe se vlera e korigjimit e cila duhet të bëhet konsumatorit është (-92.55€).

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 20.09.2013 KEDS-i ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes.

Baza e kundërshtimeve të KEK-ut të theksuara në ankesë është se konsumatori sipas listave të leximit ka lexim të rregullt dhe se nga muaji janar 2013 konsumatorit energjia elektrike i është faturuar vetëm me një tarifë dhe atë me çmime të grupit tarifor 6 (konsumator një-tarifor). Po ashtu në ankesë është theksuar se KEDS-i nuk është i obliguar që konsumatorit t'ia mirëmbaj tariforin e njehsorit elektrik.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24 tetor 2013 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara. Bordi i ZRRE-pas vlerësimit të shkresave të lëndës ka vërejtur se Departamenti i Faturimit në KEK me datë 04.01.2013 i ka dërguar në konsumatorit faturën mujore të muajit dhjetor 2012 prej 1652 kWh në vlerë prej 158.03€. Departamenti i faturimit në KEK me datë 03.02.2013 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për muajin 01/2013 me 1681 kWh apo e shprehur në vlerë financiare 251.00€. Po ashtu pas arritjes së këtyre faturave të energjisë elektrike konsumatori ka parashtruar ankesë në KEK duke kundërshtuar faturat e muajit dhjetor 2012 dhe janar 2013, për shkak të ngarkesës financiare si pasojë e mos leximit të saktë të njehsorit elektrik. Punëtorët e autorizuar të KEK-ut me datë 13.02.2013 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe se kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 7609063 e cila në momentin e inspektimit ka qenë: TL=46641 kW dhe TU= 83195 kW.

Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se konsumatori me datë 04.03.2013 dhe me datë 07.03.2013 ka kërkuar ndërrimin e njehsorit elektrik ose rregullimin e njehsorit dy tarifor ngase sipas konsumatorit në hyrjen e tij vetëm njehsorit të elektrik nuk i funksionon njehsori tarifor dhe se i gjithë shpenzimi i regjistrohët vetëm në tarifën e lartë dhe se sipas kësaj po dëmtohet konsumatori me këtë formë të faturimit. Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se punëtorët e autorizuar të KEK-ut me datë 11.04.2013 kanë dalur te konsumatorit me shifër DPR 18598 dhe gjatë inspektimit kanë konstatuar se pas verifikimit kanë konstatuar se tarifa e dytë nuk punon, por që nuk e kanë marrë asnjë veprim për të rregulluar njehsorin elektrik apo për ta ndërruar njehsorin elektrik ashtu që të matë energji elektrike njehsori në të dy tarifatat pasi që edhe ka qenë njehsor dytarifor, andaj edhe pretendimi i KKDFE-së se konsumatori i ka bërë me qëllim që të shmang përgjegjësisë nuk qëndrojnë ngase konsumatori ka parshtruar dy herë kërkesa për rregullimin e njehsorit tarifor apo ndërrimit të njehsorit elektrik si dhe ai vazhdimisht i ka paguar të gjitha faturat e energjisë elektrike edhe pse i kanë shkuar si konsumator i grupit tarifor 6.

Është analizuar edhe shpenzimi i energjisë elektrike i konsumatorit nga ana e Bordit të ZRRE-së dhe është vërejtur se konsumatori me shifër DPR – 18598 ka lexim të rregullt të energjisë elektrike, por që sipas faturave të energjisë elektrike nga periudha 08/2002 e deri më 12/2012 njehsori elektrik nr. 7609063 ka matur energji elektrike në dy tarifa, ndërsa nga periudha 01/2012 e tutje ky njehsor ka matur energji vetëm në një të një tarifë dhe atë në tarifën e lartë. Sipas analizës së bërë shpenzimit të energjisë elektrike sipas viteve vërehet se nuk ka ndryshim të shpenzimit sipas viteve, si: 2010 – 1236 kWh/muaj; 2011 – 1230 kWh/muaj; 2012 – 1199 kWh/muaj; 2013 (periudha 01/2013 – 08/2013) – 1092 kWh/muaj. Sipas kësaj vërehet qartë se shpenzimi i energjisë elektrike është pothuajse i njëjtë si para periudhës 12/2012 ashtu edhe pas asaj periudhe. Sipas analizave të bëra shpenzimit të energjisë elektrike të konsumatorit është vërejtur se njehsori elektrik nr. 7609063 prej periudhës 01/2012 – 11/2012 ka shpenzuar 18% në tarifën e lartë dhe 82% në tarifën e ulët, ndërsa në muajin 12/2012 ka shpenzuar 85% në tarifën e lartë dhe 15% në tarifën e ulët.



Bordi i ZRRE gjatë analizës së bërë procesverbale të KEK-ut dhe kërkesave të konsumatorit ka vërejtur se edhe përkundër që konsumatori ka parashtruar dy kërkesa për ndërrimin e njehsorit elektrik ose rregullimin e njehsorit tarifor, punëtorët e autorizuar të KKDFE-së nuk kanë ndërmarrë asnjë masë për të rregulluar njehsorin elektrik të konsumatorit ashtu që konsumatori me shifër DPR – 18598 të mos faturohet si konsumator i grupit tarifor 6 (njëtarifor) por të faturohet si konsumator i grupit tarifor 5 (dy tarifor), pasi që edhe njehsori elektrik i konsumatorit nr. 7609063 ka qenë dy tarifor. Bordi i ZRRE-së thekson se KEK-u por edhe KKDFE kanë gabuar kur konsumatorit nuk ia kanë ndërruar apo rregulluar njehsorin elektrik nr. 7609063, andaj për shkak të mos marrjes së masave me kohë për ndërrimin apo rregullimin e njehsorit elektrik për të matur energji në dy tarifa sipas nenit 5.5 të Kodit të Matjes, Bordi i ZRRE-së konstaton se konsumatorit duhet t'i bëhet korrigjimi i faturave të energjisë elektrike prej periudhës 01/2013 e deri më 08/2013 ashtu që shpenzimet e regjistruar për këta muaj të ndahen për secilin muaj në këtë formë: 50 % të llogaritet se ka shpenzuar me tarifën e lartë dhe 50% me tarifën e ulët.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KKDFE në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24.10.2013 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1014_09_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar